



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-059

Prishtinë, më 3 maj 2016, në orën 16:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 3 MAJ 2016

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi dhe Avni Bytyçi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari procedoi me këtë rend dite:

1. Rekomandimi i Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Komisioni Evropian nesër do ta bëjë publik rekomandimin pozitiv për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës, që mund të lëvizin pa viza në Zonën e Shengenit. Ndërsa, ne, të gjithë bashkërisht, si institucione dhe përfaqësues të qytetarëve të Kosovës do të festojmë të enjten.

Ai propozoi që të enjten, më 5 maj 2016, Kuvendi të mbajë seancë solemne, në të cilën do të jenë të pranishëm edhe përfaqësuesit e Komisionit Evropian.

Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi të mbajë seancë solemne më 5 maj 2016, në orën 16:00, me këtë:

Rend dite

1. Adresimi i Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë, zëvendës-presidente e Komisionit Evropian, znj. Federica Mogherini, deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 16:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale